



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA – GJILAN



R R E G U L L O R E
PËR TATIMIN MBI PRONËN E PALUAJTSHME
PËR VITIN FISKAL 2016

Gjilan 29.09.2015

Në mbështetje të nenit 24.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, dispozitave të Ligjit nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 04/L-100 dhe nenin 9 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e vet të mbajtur më 29.09.2015 aprovon:

R R E G U L L O R E N M B I T A T I M I N N Ë P R O N Ë

Neni. 1.

1.1. Duke u bazuar në Nenin 6 Ligjit Nr. 03/L -204 Për tatimin në pronën e paluajtshme baza tatimore do të caktohet si më poshtë:

1.2. Forma tabelare e vlerësimit sipas zonave në bazë të vlerës së tregut për m²

Zona t	Pronat Rezidenciale		Komeriale, Restaurantet, Hotelet	Industriale	Bujqësore	Garazh/Parking	Pronat e Braktisura	Terrenet sportive	Pishinat dhe Rekreacioni	Pronat e Pa përfunduara	Institucionet shkollore private	Depo/ Magazinë	Komeriale e pashfrytezuara
	Banesat	Shtëpitë											
I	470	425	1000	325	140	175	50	180	180	180	1000	500	700
I-a	440	390	920	280	140	150	50	170	170	170	920	475	644
I-b	425	365	780	235	140	140	50	150	150	160	780	400	546
II	400	340	600	200	95	110	40	110	130	150	600	300	420
III	360	300	460	160	95	80	30	110	130	130	460	230	322
IV		185	280	150	65	50	20	80	100	76	280	140	196
V		110	140	100	30	20	15	70	80	46	140	70	98

Neni 2

2.1 Duke u bazuar në vendndodhjen e pasurisë e cila ndikon dukshëm në vlerën e saj në Komunën e Gjilanit janë përcaktuar 5 zona tatimore, në kuadër të zonës së parë përfshihen edhe dy nënzona (I-a dhe I-b) .

- a) Zona e parë I -** përfshinë rrugët; Abdullah Tahiri, Bulevardi i Pavarësisë, Xhemajl Mustafa, Adem Jashari, Zija Shemsiu, 15 Qershori 99, Medlin Olbrajt, Shadërvani, Gjinollve, Haki Myderizi nga rr.Haqif Tetova deri te udhëkryqi i Rr.15 Qershori 99, Haqif Tetova(një pjesë), Esat Berisha prej rr.Xhemë Topalla deri te rr.Makfire Deda, Mulla Idrizi, nga qendra deri te xhamia e vogël dhe Mehmet Akif Ersoj.
- b) Zona e parë I/a -** Idriz Seferi nga stac.auto.-Kosova petrol, Isa Boletini, Gjon Sereqi, Xhemë Topalla, Metush Krasniqi, Nato 99, 28 Nëntori, Ramiz Cernica , Nëna Terezë

deri te Qarkorja, Avdullah Presheva deri te rr.V.Frashëri, Sadullah Brestovci deri te udhëkryqi rr.R. Dajkovci, Haqif Tetova ,Esat Berisha nga xhamia deri rrethi ne lagjen Iliria, Marije Shllaku deri te udhëkryqi i rrugës për Fsh, Shillovë. **Qarku Jugu (nga rrethi deri te rruga Mulla Idrizi).**

- c) **Zona e pare I/b** - Beqir Musliu rrugët **1a-9**, Muharrem Ibrahimimi rrugët **1-9**, Enver Miftari, Lidhja e Prizrenit, Pajazit Ahmeti (nga udhëkryqi rruga e Prishtinës deri te vetëshërbimi “Pireva”, Mulla Idrizi(qarkorja Jugu – Fabrika e Radiatorëve), Hamdi Kurteshi deri te qarkorja Jugu, Rruga e Prishtinës (nga Qarkorja deri te Pompa Calabria), Idriz Seferi (prej Kosova Petrol-udhëkryqi i Qarkores) Haki Myderizi, Halim **Orana**,Qarku Jugu nga rr.Mulla Idrizi deri te rruga Hamdi Kurteshi(Malisheves).
- d) **Zona e dytë II;** Vëllezërit Frashëri, Agim Rashiti, Isa Kastrati, Gjon Buzuku, Lekë Dukagjini, Limon Staneci,Vëllezërit Hyseni etj.
- e) **Zona e trete:** Përfshin te gjitha objektet te cilat nuk kane emërtime te rrugëve të sakta dhe objektet te cilat kufizohen me fshatrat për rreth.
- f) **Zona e katërt IV-të** përfshin këto fshatra; Malishevë, Uglar, Pogragjë Kmetovc, Dobërçan, Petrit, Përlepnice, Bresalc, Livoçi i Ulët, Livoçi i Epërm, Cërnice, Lladovë, Zhegër, LLashticë, Haxhaj, Nasalë, Ponesh, Demiraj, Velekincë, Shillovë.
- g) **Zona e pestë V-të** përfshin këto fshatra; Bilinicë, Bukovik, Capar, Burincë, Çelik, Dunav, Gadish, Goden i vogel, Inatovc, Kishnapole, Kravaricë, Lipovicë, LLovcë, Malishevë e Epërme, Muqibabë, Pidiq, Shurdhan, Sllakovc i Poshtëm, Sllakovc i Epërm ,Stanqiq, Stublinë, Verbicë e Kmetocit, Verbicë e Zhegocit, Zhegoc, Vrapqiq, Kureq, Terziaj, Selishtë, Sllubicë

2.2. Në zonën parë **I** dhe nënzonat **I/a** dhe **I/b** llogariten vetëm objektet qe kan dalje ne rrugët kryesore.

Neni 3

Në pajtim me nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme normat tatimore për vitin 2015 në Komunën e Gjilanit janë siç vijon:

Pronat rezidenciale – shtëpi	0.15 %
Pronat rezidenciale -banesë	0.15 %
Pronat komerciale	0.17 %
Pronat industriale	0.15 %
Pronat bujqësore	0.15 %
Pronat e braktisura	0.15 %
Pronat e papërfunduara	0.15 %
Garazh / Parking	0.15 %
Terrenet sportive	0.17 %
Pishina dhe rekreacionet	0.17%
Institucionet shkollore private	0.17 %
Depo / Magazinë	0.15 %
Restorantet	0.17 %
Komerciale e pa shfrytëzuar	0.17 %

Neni 4

Pronat të cilat lirohen nga tatimi në pronë e të cilat janë të cekura në nenin 8 Ligjit Nr. 03/L-204 Për tatimin në pronën e paluajtshme, lirohen nga tatimi në pronë edhe në Komunën e Gjilanit.

Neni 5

Shtyrja e pagimit të tatimit në kushte të veçanta mund të bëhet konform nenit 15 Ligjit Nr. 03/L-204 Për tatimin në pronën e paluajtshme.

Neni 6

Në pajtim me nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-204 Për tatimin në pronën e paluajtshme, dhe Udhëzimin administrativ 05/2011 neni 1 Kryetari i Komunës e emëron Bordin e pavarur për shqyrtimin e ankesave administrative të tatimpaguesve për vitin 2016.

Neni 7

Ligji Nr. 03/L-204 Për tatimin në pronën e paluajtshme në Kosovë dhe udhëzimet administrative rregullojnë të gjitha çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me tatimin në pronë e të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore komunale.

Neni 8

Normat për kualitet të objekteve mbështeten në Udhëzimin administrativ Nr. 03/2011 Për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin.

Neni 9

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës dhe e njëjta zbatohet për vitin tatimor 2016.

01.Nr. 016-95815
Gjilan, më 29.09.2015

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku - Rexhepi